



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1270 / Prot. 11

Vlorë më, 29.06. 2023

E. Blumaj

VENDIM

Nr. 22, datë 29.06.2023

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT
NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER MËSIMOR, NDIHMËSAKADEMIK ME
KARAKTER ADMINISTRATIV DHE PERSONELIT ADMINISTRATIV TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, ", VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" dhe Udhëzimit nr.16, datë 16.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e VKM nr.325, datë 31.05.2023", referuar propozimit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore me shkresë 1252/1 prot, datë 26.06.2023 si dhe shkresës së Administratorit të UV-së 1252/2, prot, datë 29.06.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 29.06.2023,

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë Vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 5, datë 02.03.2018 "Për miratimin e nivelit të pagave të personelit ndihmësakademi me karakter mësimor, personelit ndihmësakademi me karakter administrativ dhe personelit administrativ në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", i ndryshuar me Vendim të Bordit të Administrimit Nr.23, datë 18.09.2018.
2. Të miratojë nivelin e pagës për administratën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë sipas kategorive bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse si dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR


Sotir NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



Universiteti "I.Qemali" Vlore, efekti financiar ne zbatim te VKM nr. 325, date 31.05.2023																
Nr Rendor	Pozicioni	Kategoria e pages sipas VKM nr 187/2017 (shte)	Kategoria e pages sipas Udhhezimit nr 16.06.2023 (VKM nr 325/2023) Rekomandimi	Paga e pozicionit referuar VKM nr 187 date 10.3.2017	Paga e pozicionit ekuivalentur sipas Udhhezimit nr. 16.6.2023	Vlera e Pages se Grupit (leke/muaj)	Numri i punonjeseve sipas kategorive	Numri i punonjeseve (plan)	Numri i punonjeseve fakt)	Vjetesia mesatare ne pune (nr i viteve	Ne Lekë			Efekti financiar mujor 601-Nentory	Efekti financiar mujor 601-Nentory	
											Efekti financiar shtese mujor 601	Efekti Financiar total mujor	Efekti financiar shtese mujor 600			
1	Administrator në Universitet (NA)	II-b	II-1	107,000	155,000	14,000	1	1	1	9		8,849	62,699		501,592	752,388
2	Drejtor Drejtorie	III-a	III-1	86500	115,000	14,000	4	4	4	20		30,133	210,573		1,684,584	2,526,876
3	Pergjegjes Sektor	III-b	III-3	65200	95,000	14,000	14	14	14	11		82,845	578,925		4,631,400	6,947,100
4	Specialist	IV-a	IV-2	52000	70,000	14,000	35	35	35	12		123,523	863,183		6,905,464	10,358,196
5	Specialist , etj	IV-b	IV-3	40600	60,000	14,000	39	39	39	12		138,119	965,179		7,721,432	11,582,148
5	Totali						93	93	93	13		383,469	2,680,559		21,444,472	32,166,708


 REPUBLIKË E SHQIPËRISË
 UNIVERSITETI "I.QEMALI" VLORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1232/Prot.

Vlorë, më 26.06.2023

Lënda: Për ndryshimin e pagës në administratën e UV-së

BORDI I ADMINISTRIMIT të UV-së

Për dijeni: Prof.Dr. Roland Zisi
REKTOR

Z. Saimir Xhelaj
ADMINISTRATOR

KËTU

Referuar Ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pageve, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" dhe Udhëzimit nr.16, datë 16.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e VKM nr.325, datë 31.05.2023", funksioneve të Bordit të Administrimit të parashikuara në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë ...", si dhe bazuar në kompetencat e Drejtorit të DKBNJ-së, ndër të tjera për të vlerësuar nëse paga e personelit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë është në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi,

Ju bëj me dije se:

Vendimi i Bordit të Administrimit Nr. 5, datë 02.03.2018 "Për miratimin e nivelit të pagave të personelit ndihmësakademi me karakter mësimor, personelit ndihmësakademi me karakter administrativ dhe personelit administrativ në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", i ndryshuar me Vendim të Bordit të Administrimit Nr.23, datë 18.09.2018, duhet të shfuqizohen e ndryshohen nga ana Juaj me një vendim të ri, pasi aktet ligjore e nënligjore ku mbështeten tashmë janë shfuqizuar.

Referuar sa më lart, administrata e UV-së, e profilizuar në strukturë dhe organikë si personel ndihmës akademik me karakter mësimor, personel ndihmës akademik me karakter administrativ dhe personel administrativ, do të paguhet sipas këtyre kategorive, klasave të pagave për pozicione pune, elementëve të pagës bruto mujore si dhe shtesat për kushte pune.

1. Administratori i UV-së, me kategori të pagës në organikën ekzistuese II-b, do të ketë klasën e pagës II-1, me vlerë të pagës për pozicion 155 000 lekë.
 2. "Drejtor drejtorie" në rektorat, me kategori të pagës në organikën ekzistuese III-a, do të ketë klasën e pagës III-1, me vlerë të pagës për pozicion 115 000 lekë.
 3. "Përgjegjës sektori" në rektorat, me kategori të pagës në organikën ekzistuese III-b, do të ketë klasën e pagës III-3, me vlerë të pagës për pozicion 95 000 lekë.
 4. "Specialist" me kategori të pagës në organikën ekzistuese IV-a, do të ketë klasën e pagës IV-2, me vlerë të pagës për pozicion 70 000 lekë.
 5. "Specialist" me kategori të pagës në organikën ekzistuese IV-b, do të ketë klasën e pagës IV-3, me vlerë të pagës për pozicion 60 000 lekë.
 6. Përgjegjësi i sektorit dhe specialistët e IT do të përfitojnë shtesë për kushte pune (natyrë e veçantë pune) në masën 7500 lekë në muaj.
 7. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse me funksione të nëpunësit zbatues do të përfitoj shtesë për kushte pune (natyrë e veçantë pune) në masën 10 000 lekë në muaj.
 8. Shtesa e nivelit të kualifikimit që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjes nr. 1 të këtij vendimi. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 9. Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:
 - i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1– 10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21– 30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, "vite pune" do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.
10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr.325/2023, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

DREJTOR

Eloina Tozaj

Eloina Tozaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 1252/Prot.

Vlorë më 23.06.2023

Lënda: Propozim për ndryshimin e pagës në administratën e UV-së, si dhe efekti financiar për vitin 2023.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

Z. SOTIR NIKOLLA

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", Udhëzimin nr. 16, datë 16.06.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325 datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", si dhe Udhëzimin nr. Nr. 15, datë 12.6.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për një shtesë në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdësit shëndetësor" të ndryshuar, si dhe bazuar në shkresën e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore "Për ndryshimin e pages në administratën e UV-së, shkresës nr. 1061 prot., datë 26.06.2023 "Përditësimi i vjetërsisë së personelit për muajin qershor 2023 në email e MAS datë 27.03.2023, po ju përcjellim për miratim propozimin për ndryshimin e pagës në administratën e UV-së sipas kategorive të mëposhtme:

1. Administratori i UV-së, me kategori të pagës në organikën ekzistuese II-b, do të ketë klasën e pagës II-1, me vlerë të pagës për pozicion 155 000 lekë.
2. "Drejtor drejtorie" në rektorat, me kategori të pagës në organikën ekzistuese III-a, do të ketë klasën e pagës III-1, me vlerë të pagës për pozicion 115 000 lekë.
3. "Përgjegjës sektori" në rektorat, me kategori të pagës në organikën ekzistuese III-b, do të ketë klasën e pagës III-3, me vlerë të pagës për pozicion 95 000 lekë.
4. "Specialist" me kategori të pagës në organikën ekzistuese IV-a, do të ketë klasën e pagës IV-2, me vlerë të pagës për pozicion 70 000 lekë.
5. "Specialist" me kategori të pagës në organikën ekzistuese IV-b, do të ketë klasën e pagës IV-3, me vlerë të pagës për pozicion 60 000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

6. Përgjegjësi i sektorit dhe specialistët e IT do të përfitojnë shtesë për kushte pune (natyrë e veçantë pune) në masën 7500 lekë në muaj.
7. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse me funksione të nëpunësit zbatues do të përfitojë shtesë për kushte pune (natyrë e veçantë pune) në masën 10 000 lekë në muaj.
8. Shtesa e nivelit të kualifikimit që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjes nr. 1 të këtij vendimi. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
9. Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:
- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1– 10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21– 30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Efekti financiar i llogaritur në zbatim të VKM-ve të mësipërme bazuar në llogaritjet e e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse rezulton si më poshtë:

Efekti Financiar shtesë për 1 muaj vlera 2,680,561 lekë:

Efekti në artikullin 600 (Shpenzime Paga) vlera 2,297,090 Lekë.

Efekti në artikullin 601 (Shpenzime Sigurime) vlera 383,471 Lekë.

Efekti Financiar shtesë për 8 muaj (Prill- Nëntor 2023) vlera 21,444,472 lekë:

Efekti në artikullin 600 (Shpenzime Paga) vlera 18,376,720 Lekë.

Efekti në artikullin 601 (Shpenzime Sigurime) vlera 3,067,752 Lekë.

Efekti Financiar shtesë për 12 muaj vlera 32,166,731 lekë:

Efekti në artikullin 600 (Shpenzime Paga) vlera 27,565,080 Lekë.

Efekti në artikullin 601 (Shpenzime Sigurime) vlera 4,601,651.16 Lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore, efekti financiar ne zbatim te VKM nr. 325, date 31.05.2023										Ne Lekë			
Nr Rendor	pozicioni	Kategoria e pages sipas VKM nr 187/2017 (shite)	Kategoria e pages sipas Udhëzimit nr 16 date 16.06.2023 (VKM nr 325/2023)	Paga e pozicionit referuar VKM nr 187 date 10.3.2017	Paga e pozicionit e ekuivalentur sipas Udhëzimit nr. 16.6.2023	Vlera e Pagës së Grupit (leke/muaj)	Numi i punonjeseve sipas kategorive	Vjetërsia mesatare ne pune (nr i viteve)	Efekti financiar mujor 600	Efekti financiar mujor 601	Efekti Financiar total mujor	Efekti Financiar 8 mujor (Prill-Nentor)	Efekti financiar vjetor
1	Administrator në Universitet (NA)	II-b	II-1	107,000	155,000	14,000	1	9	53,850	8,849	62,699	501,592	752,388
2	Drejtor Drejtorie	III-a	III-1	86500	115,000	14,000	4	20	180,440	30,133	210,573	1,684,584	2,526,876
3	Përgjegjës Sektor	III-b	III-3	65200	95,000	14,000	14	11	496,080	82,845	578,925	4,631,400	6,947,100
4	Specialist	IV-a	IV-2	52000	70,000	14,000	35	12	739,660	123,523	863,183	6,905,464	10,358,196
5	Specialist , etj	IV-b	IV-3	40600	60,000	14,000	39	12	827,060	138,119	965,179	7,721,432	11,582,148
5	Totali						93	13	2,297,090	383,469	2,680,559	21,444,472	32,166,708

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR

Saimir XHELAJ



Konceptoi: E. Islami

Adresa /Adress: L. Pavarsia,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al